




TERMAT E REFERENCËS



Agjencia Kombëtare e Rinisë

Përmbajtja

I. Informacion i përgjithshëm mbi projektin	3
II. Objektivi i pozicionit.....	3
III. Përshkrimi i punës	3
IV. Rezultatet e pritshme.....	4
V. Kualifikimet dhe përvoja.....	4
VI. Kohëzgjatja dhe lloji i angazhimit	4
VII. Dokumentacioni i aplikimit.....	5
VIII. Procedura e përzgjedhjes.....	5
IX. Dispozita të përgjithshme.....	5

TERMA REFERENCE

Pozicioni: Ekspert komunikimi

Projekti: VOICE 2 YOUTH ALBANIA – Vocational Training Opportunities to Increase Competences and Employment among Youth in Albania

Kohëzgjatja e projektit: 36 muaj

I. Informacion i përgjithshëm mbi projektin

Projekti “VOICE 2 YOUTH ALBANIA” synon luftimin e papunësisë së të rinjve dhe promovimin e integritit socio-ekonomik përmes trajnimeve profesionale, mbështetjes për punësim dhe nxitjes së vetëpunësimit. Projekti zbatohet në Tiranë dhe Vlorë dhe përfshin forcimin e qendrave të trajnimit profesional, zhvillimin e praktikave ndërkombëtare, mbështetjen për startup-e dhe krijimin e rrjeteve ndërmjet institucioneve publike, bizneseve dhe diasporës.

Agjencia Kombëtare e Rinisë merr pjesë si institucion publik partner në zbatimin e aktiviteteve të projektit.

II. Objektivi i pozicionit

Eksperti/ja i/e Komunikimit do të jetë përgjegjës/e për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të komunikimit dhe dukshmërisë së AKR në kuadër të projektit VOICE 2 YOUTH ALBANIA, me qëllim promovimin e rezultateve të projektit dhe sigurimin e përputhshmërisë me udhëzimet e financuesit dhe partnerit lider.

III. Përshkrimi i punës

1. Strategjia e komunikimit dhe dukshmërisë

- Harton dhe zbaton planin e komunikimit të AKR në kuadër të projektit.
- Siguron përputhshmërinë me udhëzimet e dukshmërisë së financuesit.
- Përgatit materiale informuese dhe promovuese për projektin.

2. Menaxhimi i përmbajtjes dhe mediave

- Harton njoftime për shtyp, artikuj dhe përmbajtje për publikim në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AKR.
- Dokumenton aktivitetet përmes fotografive, videove dhe materialeve të tjera vizuale,
- Koordinon publikimin e rezultateve dhe historive të suksesit të përfituesve.

3. Komunikimi me palët e interesit

- Mbështet organizimin e eventeve dhe aktiviteteve nga pikëpamja e komunikimit publik.
- Bashkëpunon me partnerët për harmonizimin e mesazheve dhe identitetit vizual të projektit.
- Promovon aktivitetet dhe rezultatet në nivel lokal dhe kombëtar.

4. Monitorimi dhe raportimi i dukshmërisë

- Përgatit raporte mbi aktivitetet e komunikimit dhe indikatorët e dukshmërisë.
- Monitoron impaktin e komunikimit dhe angazhimin e audiencës.

5. Mbështetja në zhvillimin strategjik dhe qëndrueshmërinë

- Siguron që komunikimi i projektit të jetë në përputhje me prioritetet strategjike të AKR.
- Kontribuon në promovimin e praktikave të mira dhe rezultateve të projektit për përdorim afatgjatë.

IV. Rezultatet e pritshme

- Zbatim efektiv i planit të komunikimit të projektit.
- Rritje e dukshmërisë së projektit dhe rolit të AKR në nivel kombëtar.

V. Kualifikimet dhe përvoja

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere:

- Diplomë universitare në komunikim, marrëdhënie me publikun, marketing, menaxhim, ose fusha të ngjashme; diplomë e nivelit Master përbën avantazh.
- Përvojë praktike në hartim materialesh komunikimi, menaxhim rrjetesh sociale dhe organizim eventesh.
- Aftësi shumë të mira në hartim dhe redaktim tekstesh në shqip dhe anglisht.
- Përvojë në menaxhimin e rrjeteve sociale dhe krijimin e përmbajtjes digjitale.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të menaxhuar disa detyra njëkohësisht.

VI. Kohëzgjatja dhe lloji i angazhimit

Angazhimi do të jetë për një periudhë që përkon me kohëzgjatjen e projektit (36 muaj), me intensitet pune sipas nevojave të planit të aktiviteteve.

Lloji i kontratës do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e menaxhimit financiar të projektit.

VII. Dokumentacioni i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- CV të përditësuar;
- Letër motivimi që përshkruan përvojën dhe aftësitë e tyre relevante;
- Çdo dokument tjetër mbështetës që vërteton përvojën profesionale.

VIII. Procedura e përzgjedhjes

- **Faza 1:** Shqyrtimi i kualifikimeve dhe eksperiencës.
- **Faza 2:** Intervistë profesionale në shqip dhe anglisht.

AKR rezervon të drejtën të mos përzgjedhë asnjë kandidat nëse nuk plotësohen kriteret e kërkuara.

IX. Dispozita të përgjithshme

Angazhimi në këtë projekt do të realizohet në përputhje me marrëveshjen e financimit të projektit, udhëzimet e AICS dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Çdo konflikt i mundshëm interesi duhet të deklarohet nga kandidati.

Të dhënat personale do të trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

X. Afati për aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën elektronike info@rinia.gov.al deri më datë 20 Shkurt 2026, ora 16:00.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

"Rruga Naim Frashëri" nr 37, Tiranë, Shqipëri

AKR është një punëdhënës me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit sipas nevojave të AKR.